

VENDIM
Nr. 27, datë 26.3.2012

PËR DHËNIE LICENCE PËR TELEVISIONIN PRIVAT KABLLOR
“TV KABLLOR ORDEA”
SUBJEKTIT: PERSONIT FIZIK SHPRESA SHAQI

Në mbështetje të ligjit nr. 8410, datë 30.9.1998 “Për radion dhe televisionin publik dhe privat në Republikën e Shqipërisë”, të ndryshuar, rregullores “Për licencimin e operatorëve privatë radiotelevizivë të transmetimeve me kablo”, miratuar me vendimin nr. 221, datë 30.3.2004 të KKRT-së, të ndryshuar dhe rregullores “Mbi procedurat e licencimit dhe rilicencimit të operatorëve privatë radio e televizivë”, miratuar me vendimin nr. 1, datë 29.1.2010 të KKRT-së, pasi mori në shqyrtim kërkesën e subjektit, personit fizik Shpresa Shaqi për t’u licencuar si operator televiziv privat kabllor dhe mbështetur në propozimin e komisionit të shqyrtimit të dokumentacionit, Këshilli Kombëtar i Radios dhe Televizionit

VENDOSI:

1. T’i japë licencë, subjektit fizik Shpresa Shaqi, duke e autorizuar të funksionojë si operator televiziv kabllor privat për “TV kabllor Ordea”, në fushën e transmetimeve televizive private kabllore për një periudhë prej 6 (gjashtë) vjetësh nga data e hyrjes në fuqi të kësaj licence, në rrethin Devoll dhe komunën Ligenas.

2. Në aneksin e licencës jepen kushtet e licencës, ku përfshihen struktura programore, zona e mbulimit, kushtet teknike dhe tarifat.

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

KRYETARE
Endira Bushati